



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM  
Nr. 44, datë 24.05.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT KRISTAQ TRAJA NË VENDIN  
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA  
KUVENDI, NË DATËN 12.02.2018

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

|                         |                              |
|-------------------------|------------------------------|
| <b>Ardian Dvorani</b>   | - Kryetar                    |
| <b>Vitore Tusha</b>     | - Zëvendëskryetare- Relatore |
| <b>Fatri Islamaj</b>    | - Anëtar                     |
| <b>Margarita Buhali</b> | - Anëtare                    |
| <b>Fatjona Memçaj</b>   | - Anëtare                    |
| <b>Eriol Roshi</b>      | - Anëtar                     |

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,  
Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,  
- **zonjës Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 24.05.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQATAR  
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

**Zoti Kristaq Traja**

**OBJEKTI :**

**Urdhërimi i lejimit ose ndalimit të kandidimit të zotit Kristaq Traja, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.**

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **zonjës Vitore Tusha**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, **zonja Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi, në datën 12.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Vladimir Kristo.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zoti Kristaq Traja.
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Vitore Tusha.
7. Zoti Kristaq Traja, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Kristaq Traja, gjendet e administruar në dosjes e kandidimit.

8. Në datën 10.04.2019, kandidati Kristaq Traja është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati zoti Kristaq Traja ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizime përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Kristaq Traja, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës. Sipas kësaj Deklarate, rezulton se kandidati Kristaq Traja është paraqitur pranë zyrës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe e ka nënshkruar atë në datën 10.04.2019.

12. Me shkresën nr. 2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Kristaq Traja nuk e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë. Sipas ILDKPKI afati 15 ditor për dorëzimin e plotësuar të Deklaratës së pasurisë ka qenë data 15.04.2019.

13. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", në datën 03.05.2019, është njoftuar kandidati Kristaq Traja mbi të drejtën e tij për të paraqitur, me shkrim, brenda datës 07.05.2019, drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me këtë gjetje të procedurës së verifikimit, si edhe dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij. Njëkohësisht, bashkë me njoftimin i janë dërguar për tu njohur edhe kopje elektronike të akteve të sipërcituara.

14. Kandidati Kristaq Traja, në datën 07.05.2019, ka dërguar në rrugë elektronike shpjegimet e tij me shkrim lidhur me gjetjet e njoftuara të procedurës së verifikimit për sa i përket kontrollit të pasurisë.

15. Në thelb, në shpjegimet e tij, kandidati Kristaq Traja, parashtroi se vonesa ka ardhur si pasojë e faktit se djemtë e tij banojnë në Francë, e janë në lëvizje të vazhdueshme, dhe për këtë shkak ka qenë e pamundur që formularët e deklaramit të tyre të depozitohen në afat.

16. Pas kryerjes së veprimeve procedurale të sipërcituara, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 dhe të pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 30 dhe 76 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, ka përgatitur relacionin mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë lidhur me kandidatin Kristaq Traja dhe në datën 23.05.2019 e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

17. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 24.05.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit ose ndalimit të kandidimit të zotit Kristaq Traja, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

18. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

19. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 24.05.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

20. Njëkohësisht, për shqyrtimin në këtë mbledhje të çështjes lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit për sa i përket kushteve dhe kriterëve të integritetit pasuror, është njoftuar edhe kandidati Kristaq Traja.

21. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtuar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

22. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se nuk vëren parregullsi në procedurat e ndjekura deri më tani për verifikim e kandidaturës. Lidhur me shpjegimet e kandidatit për pamundësinë objektive për të dorëzuar deklaratën e pasurisë nisur nga fakti se djemtë e tij banojnë në Francë, e janë në lëvizje të vazhdueshme, dhe për këtë shkak ka qenë e pamundur që formularët e deklaramit të tyre të depozitohen në, të mbahet parasysht se pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 ka përcaktuar shprehimisht detyrimin e kandidatëve që Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë ta dorëzojnë të plotësuar pranë ILDKPKI *“jo më vonë se 15 ditë nga marrja pranë Këshillit të formularëve për deklarimin e pasurisë”*. Ligji nuk i njeh as ILDKPKI dhe as Këshillit kompetenca për të pranuar Deklaratën përtej afatit 15 ditor.

## II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Kristaq Traja për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

24. Në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

*.....  
dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.”.*

25. Në nenin 235 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se :

*“Neni 235 Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së kandidatëve*

*1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë.*

*2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.*

*3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.*

*4. Me përfundimin e procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar.”.*

26. Në pikën 30, 51, 52 dhe 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, parashikohet se :

*“30. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.”*

*“51. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:*

*a) deklarimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati;*

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.”

“52. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të Këshillit gjatë procedurës së verifikimit, kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.”

“78. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

- a) ka refuzuar të përmbushë detyrimin për tu pajisur me formularin e deklaratës së pasurisë ose nuk e ka plotësuar dhe depozituar atë pranë ILDKPKI sipas ligjit;
- b) ka refuzuar nënshkrimin e autorizimeve të kërkuara nga Këshilli për verifikimin e pasurisë.”

27. Këshilli vlerëson se, në zbatim të ligjit nr. 115/2016 dhe të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ILDKPKI është ngarkuar me kompetenca për kontrollin e pasurisë së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të cilat i ushtron duke zbatuar edhe rregullat e përgjithshme ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003 mbi afatet, kushtet dhe mënyrën e plotësimit, depozitimit dhe të kontrollit të të dhënave të deklaruara nga subjektet që i nënshtrohen kontrollit të pasurisë dhe interesave private.

28. Në këtë kuptim, ILDKPKI ka edhe kompetencën të verifikojë dhe të konfirmojë zyrtarisht nëse kandidati i përfshirë në listën e dërguar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është paraqitur ose jo për dorëzimin e Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, nëse është paraqitur dhe e ka dorëzuar këtë Deklaratë brenda afatit 15 ditor të përcaktuar shprehimisht nga ligji apo nëse e ka plotësuar këtë Deklaratë sipas kërkesave të ligjit në mënyrë që ajo të pranohet për shqyrtim nga ana e ILDKPKI.

29. Në rastet kur konstaton se kandidati nuk i ka respektuar detyrimet, afatet dhe modalitetet e përcaktuara ligji për deklarimin e pasurisë dhe interesave private, krahas ushtrimit të kompetencave të tjera që i njeh ligji, përfshirë atë për të mos vijuar me kontrollin e pasurisë së kandidatit, ILDKPKI e njofton Këshillin e Emërimeve në Drejtësi mbi mosrespektimin e detyrimit ligjor nga kandidati për dorëzimin e deklaratës ose për dorëzimin e saj të plotësuar jashtë afatit 15 ditor apo për mosrespektimin e përcaktimeve ligjore për mënyrën e plotësimit të deklaratës.

30. Nga aktet që përmban dosja e kandidimit rezulton që kandidati Kristaq Traja është njoftuar me shkrim në rrugë elektronike për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturës, është paraqitur pranë Këshillit dhe ka nënshkruar deklaratën se është pajisur me formularët e deklarimeve dhe autorizimeve të cilat duhet ti plotësojë dhe dorëzojë sipas ligjit.

31. Në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit duke i bashkëlidhur edhe deklaratën e pajisjes me formularët e deklarimeve dhe autorizimeve që përmban edhe datën e nënshkrimit të saj. Në këtë listë është i përfshirë edhe kandidati Kristaq Traja dhe personat e lidhur me të sipas ligjit.

32. Afati 15 ditor i parashikuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 brenda të cilit kandidati duhet të ketë dorëzuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë pranë ILDKPKI fillon nga dita e nesërme e pajisjes nga Këshilli me formularin e kësaj Deklarate, pra nga dita e nënshkrimit të deklarimit se është pajisur me këtë formular.

33. Nga aktet që përmban dosja e kandidimit rezulton që kandidati Kristaq Traja është pajisur me këtë formular dhe ka nënshkruar deklarin përkatës në datën 10.04.2019. Pikërisht, nga e nesërmeja e kësaj date fillon të ecë edhe afati 15 ditor i detyrimit të kandidatit Kristaq Traja për dorëzimin e Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

34. Ndërkohë që, ILDKPKI, me shkresën nr. 2854/4 prot, datë 03.05.2019, ka njoftuar Këshillin se kandidati Kristaq Traja nuk është paraqitur për të dorëzuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë. Dita e fundit e afatit ligjor për dorëzimin e kësaj Deklarate ishte data 25.04.2019.

35. Këshilli vëren se, nga aktet e procedurës së verifikimit, rezulton që kandidati Kristaq Traja nuk e ka dorëzuar Deklaratën e plotësuar të Pasurisë pranë ILDKPKI. Kandidati shpjegon se dorëzimi i Deklaratës brenda afatit 15 ditor nuk ishte i mundur për shkak se djemtë e tij banojnë në Francë, e janë në lëvizje të vazhdueshme, dhe për këtë shkak ka qenë e pamundur që formularët e deklarimit të tyre të depozitohen në këtë afat.

36. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se duhet të mbahet parasysh se pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 ka përcaktuar shprehimisht detyrimin e kandidatëve që Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë ta dorëzojnë të plotësuar pranë ILDKPKI *“jo më vonë se 15 ditë nga marrja pranë Këshillit të formularëve për deklarimin e pasurisë”*. Po kështu, ligji nuk parashikon raste përjashtimore dhe nuk i njeh as ILDKPKI dhe as Këshillit kompetenca për të pranuar Deklaratën e plotësuar të Pasurisë përtej afatit 15 ditor.

37. Për shkak të mosrespektimit të detyrimit ligjor për dorëzimin pranë ILDKPKI të plotësuar të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë ose për dorëzimin e saj tej afatit 15 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 apo dorëzimin e kësaj Deklarate të plotësuar pa respektuar kushtet që përmban Ligji nr. 9049/2003, kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson edhe njërin nga kushtet ligjore të kandidimit të parashikuar nga dispozita e posaçme e shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që: *“të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.”*

38. Prandaj, duke u bazuar në aktet që përmban dosja e kandidimit të analizuara më sipër në këtë vendim dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të shkronjës “a” të pikës 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Kristaq Traja në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

## **VENDOSI:**

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Kristaq Traja, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Kristaq Traja.
3. Kandidati Kristaq Traja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian DVORANI**

